



BULETINI M U J O R I

JANAR 2026



► **Reforma në sistemin spitalor: Nis puna për rritjen e kapaciteteve të Shërbimit Onkologjik në 7 spitale rajonale**

Në vitin 2026 nis riformatimi i thellë i sistemit spitalor në vend. Ministria prof. Evis Sala theksoi rritjen e kapaciteteve të kimioterapisë në 7 spitale rajonale dhe implementimin e protokolleve të reja të onkologjisë, sipas modeleve bashkëkohore, në bashkëpunim me Institutin e Tumoreve në Milano.



► *Miratohet në Kuvend Ligji i ri “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”*

Kuvendi miratoi ligjin “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, një nismë e MSHMS-së, me kontribut të UNDP dhe UN Women në Shqipëri, nëpërmjet të cilit sigurohet mbrojtja nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, për mbrojtjen e jetës, dinjitetit dhe sigurisë së grave, vajzave, fëmijëve, moshës së tretë dhe personave me aftësi të kufizuara.



► *Zgjerohet fasha e grupmoshave për depistimin e kancerit të qafës së mitrës*

Në kuadër të javës Europiane për Parandalimin e Kancerit të Qafës së Mitrës, ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala informoi se duke filluar nga viti 2026, Programi Kombëtar i Depistimit të Kancerit të Qafës së Mitrës zgjeron fashën e grupmoshës së grave përfituese, nga 40-50 vjeç në 35-55 vjeç, një nismë që synon ndërgjegjësimin për kontrolle dhe uljen e rrezikut ndaj kësaj sëmundjeje.



► *Shqipëria forcon partneritetin me Austrinë dhe ANEB për shëndetësinë dhe onkologjinë*

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, prof. Evis Sala gjatë vizitës zyrtare në Vjenë zhvilloi një takim me homologen austriake Korinna Schumann ku u diskutua zgjerimi i bashkëpunimit përmes një Marrëveshjeje të re në Shëndetësi në 2026-2030, si dhe me përfaqësuesit e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore (ANEB) në funksion të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për reformën në shëndetësi dhe zhvillimin e onkologjisë në vend.



► Qendër e re Komunitare në Divjakë, 14 shërbime të reja sociale gjatë 2026 në 61 bashki

Gjatë vizitës në Qendrën e re Komunitare në Divjakë, ministri Sala deklaroi se zgjerimi i hartës së shërbimeve sociale do të vijojë edhe gjatë këtij viti, nëpërmjet Fondit Social do të shtohen edhe 14 shërbime të reja sociale në 61 bashki të vendit, duke forcuar mbrojtjen sociale në nivel vendor dhe duke siguruar që shërbimet t'u afrohen gjithnjë e më shumë qytetarëve, aty ku ata jetojnë.




► *Nis vaksinimi kundër HPV-së edhe për djemtë e moshës 13 vjeç*

Ka nisur aplikimi i vaksinimit ndaj HPV-së edhe për djemtë e moshës 13 vjeç, si pjesë e Kalendarit Kombëtar të Vaksinimit, miratuar nga MSHMS. Vaksina kundër HPV-së kryhet në çdo Qendër Shëndetësore dhe mbron vajzat dhe gratë nga kanceri i qafës së mitrës, tek meshkujt ndihmon në parandalimin e disa llojeve të kancereve të lidhura me HPV-në, si dhe ndikon në uljen e qarkullimit të përhapjes së virusit në popullatë.

Vaksina kundër HPV është e sigurt dhe efektive.



VAKSINONI VAJZAT DHE DJEMTË TUAJ



► *Korpusi i ri i Laboratorëve të ISHP-së, qendër kombëtare reference për shëndetin publik*

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, inspektoi godinën e re të Korpusit të Laboratorëve Referencë Kombëtare të Institutit të Shëndetit Publik, një investim strategjik kombëtar me buxhetin e shtetit, që pritet të vihet në funksion brenda vitit 2026 dhe do të përbëjë një nga kapacitetet laboratorike më moderne në rajon.



► **Bashkëpunimi i spitaleve ndërkombëtare me ato publike në Shqipëri, kontribut për ekselencën mjekësore**

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, gjatë vizitës në Spitalin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Tiranë, i cili do të bashkëpunojë me Spitalin Pediatrik Bambino Gesù (OPBG) në Romë, theksoi rëndësinë e bashkëpunimeve të tilla dhe se sektori shëndetësor publik mbetet i hapur për të sjellë ekselencën mjekësore në vend.



► Nis puna për zbatimin e ligjit “Për barazinë Gjinore”

MSHMS në bashkëpunim të ngushtë me UN Women në Tiranë, zhvilloi takimin e parë konsultativ me nëpunësit e barazisë gjinore nga institucione të ndryshme publike për nisjen e procesit të koordinimit ndërinstytucional për hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit në funksion të zbatimit të Ligjit të ri për Barazinë Gjinore.





BULETINI M U J O R I

JANAR 2026